



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT

MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK



Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/54;
Datë: 29.05.2015 .

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA Komuna Junik-Opština Junik		
02/Nr.Port.	Nr.i faq	Data
2015-5235	1	09.06.2015

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 22 paragrafi 4 të statutit të komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26) dhe nenit 7 paragrafi 3 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 29.05.2015 nxjerrë:

V E N D I M

për

formimin e Grupit të punës për hartimin e (projekt) Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2016

I. Me këtë vendim formohet Grupi i punës për hartimin e (projekt) Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2016/në tekstin e mëtejme Grupi i punës/.

II. Grupi i punës ka për detyrë që të hartojë (projekt) Planin vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2016 në përputhje me nenin 7 paragrafi 2 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut.

III. Grupin e punës e përbëjnë nga një përfaqësues i subjekteve politike të përfaqësuara në kuvend, një përfaqësues nga ekzekutivi i komunës, kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa, kryesuesi i Komitetit për Komunitete dhe kryesuesja e Grupit të Femrës së Komunës së Junikut.

IV. Afati i hartimit të (projekt) Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut është më së largu deri në fund të muajit korrik të këtij viti.

V. Pas hartimit të (projekt) Planit të punës nga ana e Grupit të punës, (projekt) Plani i dërgohet Kuvendit të Komunës së Junikut për shqyrtim dhe miratim.

VI. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen vendimet tjera me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

VII. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. kryetarit i Komunës së Junikut;
3. shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut, dhe
4. Arkivi i komunës.

Kuvendi i Komunës së Junikut,

Faik Tofaj

kryesues



Adresa:

Tel.: +386 (0) 49 760 270

<http://rks-gov.net/junik>